



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, nenit 22 par. 1.1 të Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve 15Nr.011-70915 e datës 28.12.2016 si dhe Rekomandimit të Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve për klube sportive 1-400-18576 i datës 12.04.2017, Kryetari i Komunes nxjerr:

**VENDIM
PËR MBËSHTETJE FINANCIARE PËR KLUBET SPORTIVE**

Neni

Ndahet shuma e mjeteve për ti mbështetur financiarisht klubet sportive për vitin 2017, të cilët kanë aplikuar sipas Ftesës publike për aplikim nr.111-7970 e datës 27.02.2017, sipas tabelës në vijim:

Nr.	Emri i klubit sportiv	Shuma
1.	Klubi i hendbollit ""Ulpiana"" (meshkujt)	1500 €
2.	Klubi i hendbollit ""Ulpiana"" (femrat)	1300 €
3.	Klubi i Volejbollit ""Ulpiana"" (meshkujt)	2000 €
4.	Klubi i Atletikës ""Blinaja""	2000 €
5.	Klubi i Gjimnastikës ""Lipjani""	1300 €
6.	Klubi i volejbollit ""Shpella e Mermertë""	1900 €
7.	Klubi i Shahut ""Ulpiana""	1200 €
8.	Klubi i Shahut ""B-Chess""	400 €
9.	Shoqata e pedagogëve e sporteve shkollore	1000 €

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2017, pozicionet buxhetore - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës dhe subvencionet e planifikuara për Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 3

Të drejtat dhe obligimet në mes të Komunës dhe Klubeve Sportive do të përcaktohen më detajisht në Marrëveshjen e cila do të lidhet në mes Kryetarit të Komunës dhe secilit klub sportiv veq e veq

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës , Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

1Nr. 400-19687

Lipjan, më 18.04.2017



KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti